



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Departamenti për Politikat e Arsimit Parauniversitar
Divizioni i Arsimit me Nevoja të Veçanta



UDHËZUES PËR PUNËN E MËSUESIT UDHËTUES

Prishtinë, 2017



PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. QENDRAT BURIMORE NË KOSOVË	6
3. PROFILI I PUNËS SË MËSUESIT UDHËTUES	8
3.1. Planifikimi dhe raportimi	9
3.2. Dokumentimi i përvojave pozitive në shkolla	10
4. PROMOVIMI I ARSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS	13
5. BASHKËPUNIMI I QENDRAVE BURIMORE ME INSTITUCIONE ARSIMORE	14
5.1. Drejtoritë Komunale të Arsimit- DKA	15
5.2. Qendrat për punë sociale	16
5.3. Organizata joqeveritare	16
6. FUNKSIONIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SHKOLLA	17
6.1. Bashkëpunimi me mësuesit klasor dhe lëndor	18
6.2. Bashkëpunimi mes mësuesve udhëtues	20
6.3. Bashkëpunimi me mësuesit mbështetës	20
6.4. Bashkëpunimi me asistent për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore	20
6.5. Bashkëpunimi me profesionist tjerë	21
6.6. Bashkëpunimi me prindër	21
7. PËRFUNDIM	22



UDHËZUES PËR PUNËN
E MËSUESIT UDHËTUES



1. HYRJE

Udhërrëfytesi për mësuesit udhëtues është hartuar në bashkëpunim me mësuesit udhëtues me qëllim të përkrahjes së punës së tyre misionare që kanë për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë.

Qëllimi i udhërrëfyesit është që të vendoset një sistem i qartë dhe unik i punës së mësuesve udhëtues në mënyrë që të ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse dhe cilësore dhe t'i kontribuojnë rritjes së përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor të Kosovës.

Udhërrëfytesi trajton çështje të ndryshme që lidhen me punën e mësuesit udhëtues, rolin dhe detyrat si dhe bashkëpunimin me akteret e ndryshëm. Pjesa e parë u referohet Qendrave Burimore në Kosovë, procesit të transformimit të tyre nga shkollat speciale në qendra burimore duke përfshi edhe politikën dhe legjislacionin përcjellës.

Pjesa e dytë përshkruan profilin e punës së mësuesit udhëtues, roli dhe detyrat, planifikimi dhe raportimi i punës së mësuesve udhëtues, me theks të veçantë dokumentimit të përvojave pozitive në shkolla me qëllim që këto përvoja të përdoren përcillen edhe tek mësuesit tjerë.

Pjesa e tretë e udhëzuesit i referohet promovimit të arsimit gjithëpërfshirës dhe rolit të Qendrave Burimore, e në veçanti mësuesit udhëtues në këtë proces. Pjesa e katërt fokusohet te bashkëpunimi i Qendrave Burimore me institucione arsimore, Drejtoritë Komunale të Arsimit, qendra sociale dhe organizatave të ndryshme joqeveritare, shoqatave etj.

Pjesa e pestë fokusohet në funksionimin e shërbimeve mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta në shkolla, rolit të mësuesit udhëtues dhe bashkëpunimi me profesionistë të cilët ofrojnë arsimim por edhe mbështetje për shkollat në drejtim të adresimit të nevojave individuale të të gjithë fëmijëve.

2. QENDRAT BURIMORE NË KOSOVË

Reforma e Qendrave Burimore (QB) ka filluar në vitin 2006. Në këtë reformë shkollat speciale u transformuan në Qendra Burimore për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe mësimdhënësve të tyre në shkollat e rregullta. Procesi filloi në tri shkolla speciale, "Xheladin Deda" në Pejë, "Përparimi" në Prishtinë dhe "Nëna Terezë" në Prizren. Ligji për arsimin parauniversitar në vitin 2011 i funksionalizoi edhe formalisht Qendrat Burimore nga i cili ligj u nxor edhe Udhëzimi administrativ nr. 23/2013 për Qendrat burimore në vitin 2013.

Sipas Ligjit, Ministria mund të themelojë dhe mirëmbajë qendra burimore, shkolla speciale dhe njësi të tjera të cilat ofrojnë arsimim special për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta ose me vështirësi në mësimnxënie për të cilët është vlerësuar se nuk janë në gjendje të arsimohen në shkollat komunale ose institucionet publike të trajnimit. Qendrat burimore dhe njësitë e tjera speciale të themeluara duhet të ofrojnë në kuadrin e burimeve në dispozicion ndihmën sipas kërkesës për institucionet arsimore dhe/ose institucionet e trajnimit që arsimojnë nxënësit me vështirësi në mësimnxënie.

Qendrat burimore funksionojnë drejtpërdrejtë nën administrimin e MASHT-it. Qendrat burimore i kanë dy funksione kryesore:

- 1) Funksionin si shkolla speciale për nxënësit me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta dhe sigurimin e akomodimit në konvikte për ata që kanë nevojë; dhe
- 2) Shërbimet mbështetëse për ofrimin e mbështetjes shkollave të rregullta në mësimdhënie për nxënësit me NVA.

Shkolla speciale dhe shërbimet mbështetëse bashkëpunojnë ngushtë për të shkëmbyer informatat, njohuritë, ekspertizën, hulumtimet dhe burimet. Ndër shtyllat kryesore të shërbimeve të mbështetjes janë mësuesit udhëtues të cilët sigurojnë urën lidhëse mes qendrës burimore dhe shkollave. Mësuesit udhëtues kanë avancuar punën e tyre pas përvojës disavjeçare me kualitetin e mbështetjes të cilën e japin në shkolla të rregullta.



Nevojat për mbështetje po rriten me rritjen e vetëdijes për rëndësinë e mbështetjes që e japin mësuesit udhëtues në shkolla të rregullta.

Sfida kryesore është rritja e numrit të mësuesve udhëtues në Qendrat burimore për dëmtime shqisore për shkaqe të mbulimit të tërë territorit të Kosovës dhe numrit të mësuesve në Qendrat burimore për dëmtime intelektuale për shkak të numrit të madh të fëmijëve dhe kërkesave për mbështetje.

Qendrat burimore dhe njësitë e tjera të themeluara gjithashtu ofrojnë ndihmesë në kuadër të resurseve që kanë në dispozicion, në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore dhe aftësuese që arsimojnë nxënësit me vështirësi në mësim. Qendrat burimore kanë shërbimet e mbështetjes me staf me përbërje të koordinatorit, mësuesve udhëtues dhe grupit mbështetës për t'u dhënë përkrahje shkollave të rregullta për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Paraqitja tabelore e Qendrave Burimore në Kosovë

Nr	Qendra Burimore	Vendi	Lloji i dëmtimit	Telefoni
1.	“Përparimi”	Prishtinë	Dëmtime intelektuale	038 603 322
2.	“Nëna Terezë”	Mitrovicë	Dëmtime intelektuale	028 515 538
3.	“Lef Nosi”	Prizren	Dëmtime intelektuale	029 241 037
4.	“Xheladin Deda”	Pejë	Dëmtime në të parë	039 433 542
5.	“Nëna Terezë”	Prizren	Dëmtime në dëgjim	029 223 628

3. PROFILI I PUNËS SË MËSUESIT UDHËTUES

Mësuesit udhëtues janë profesionist në fushën e edukimit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore puna e tyre fokusohet jashtë qendrës burimore, për të ofruar mbështetje nxënësve dhe mësime të veçanta në shkollë por edhe brenda qendrës në shërbimet e mbështetjes.

Mësuesit udhëtues kanë rol shumë dimensional dhe për veç mbështetjes specifike për nxënës me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në mësim ata mbulojnë edhe fushat tjera që lidhen me promovimin e arsimit gjithëpërfshirës si :

- Identifikimin e nevojave për mbështetje të fëmijët me nevoja të veçanta në shkollë;
- Vlerësimin e nevojave për mbështetje pedagogjike;
- Përkrahin procesin e tranzicionit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga qendrat burimore në shkollat e rregullta;
- Këshillimin e mësimeve të veçanta, shërbimeve pedagogjike dhe drejtorëve;
- Dhënie të këshillave lidhur me pajisjet dhe materialet e nevojshme për nxënësit;
- Hartimin, shkrimin dhe rishikimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) në bashkëpunim me mësimeve të veçanta dhe prindërit;
- Modifikimin e përmbajtjes së kurrikulës, strategjive të mësimeve të veçanta, materialeve dhe vlerësimi në bazë të nevojave individuale të nxënësve;
- Intervenimin dhe përgatitjen e planeve mësimore;
- Realizon punë individuale me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, (sipas nevojës - mësim shtesë në qendrën burimore);
- Mban trajnime për mësimeve të veçanta e qendrës burimore sipas kërkesave dhe nevojave mësimore;
- Ndihmon mësimeve të veçanta e qendrës në kuptimin dhe zëvendësimin e aftësive sipas fushave të aktiviteteve mësimore;
- Monitorimin e përparimit të arritjeve për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- Ofron rekomandime dhe sugjerime për të krijuar materialet

didaktike të duhura dhe alternative;

- Modifikon materialet në sistemin Brail;
- Identifikimi i nevojave për mbështetjen e stafit mësimdhënës në shkolla;
- Bashkëpunon me DKA-të, OJQ-të;
- Bashkëpunon me ekipet në qendrën burimore;
- Bashkëpunon me rrjetin e mësuesve udhëtues;
- Krijimi i bazës së të dhënave për procesin e mbështetjes.

3.1. Planifikimi dhe raportimi

Në kuadër të punës së tyre, mësuesit udhëtues vazhdimisht e dokumentojnë punën e tyre në çdo fazë të punës dhe për të gjitha shërbimet që ofrojnë. Puna e tyre fillon me planifikimin si bazë për të arritur objektivat e caktuara në politikat e qendrës burimore por edhe në përshkrimin e detyrave të tyre. Mësuesit udhëtues bëjnë plane dhe raporte, mbajnë dosje të ndryshme për nxënës varësisht nga natyra e shërbimeve që japin:

- Plane vjetore (mujore, javore dhe ditore);
- Raporte vjetore, mujore, javore dhe ditore;
- Dosje të nxënësve që mbështeten nga QB-ja;
- Dosje të nxënësve që marrin mësim shtesë;
- Raporte nga vizitat tek nxënësit e mbështetur;
- Raporte nga takimet me (DKA-të¹, Ekipin Komunal të Vlerësimit, OJQ-të, drejtoritë dhe institucionet tjera);
- Procesverbale të mbledhjeve me ekipet bërthamë, shërbimet mbështetëse, ekipin e vlerësimit në QB;
- Formularë për aprovim nga prindi për integrim dhe tranzicion.

¹ Drejtoria Komunale e Arsimit

3.2. Dokumentimi i përvojave pozitive në shkolla

Në kuadër të punës së mësuesit udhëtues dokumentimi i përvojave pozitive në shkolla është ndër misionet me shumë rëndësi.

Gjithëpërfshirja në arsim si proces në Kosovë ka filluar nga viti 2004 dhe nga ajo kohë ka pasur shumë përpjekje për të ndryshuar qasjen e institucioneve arsimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Pas disa viteve pune në kemi institucione arsimore që kanë praktika të mira për sa i përket gjithëpërfshirjes por kemi edhe shkolla që nuk kanë pasur mbështetje nga programet apo projektet, por që bazuar në politikat e MASHT-it po punojnë në adresimin e punës me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Gjithë këtij ndryshimi kanë kontribuar edhe intervenimet në shumë shkolla përmes programeve, projekteve të ndryshme në mënyre që të krijohen modele të shkollave gjithëpërfshirëse. Të gjitha programet dhe projektet kanë pasur në fokus ndryshimin e kulturës, politikave dhe praktikave në shkolla që ato të jenë gjithëpërfshirëse.

Gjithashtu, bazuar në legjislacionin në fuqi janë krijuar edhe mekanizma si mësuesit mbështetës, asistentët të cilët janë burim i rëndësishëm i mbështetjes së nxënësve me nevoja të veçanta dhe shkollave për të krijuar një ambient të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës. Rol të rëndësishëm në këtë proces kanë luajtur edhe mësuesit udhëtues të cilët vizitojnë dhe mbështesin shumë mësimdhënës dhe nxënës në shkolla të rregullta, e që po ashtu janë një burim tjetër me rëndësi në mbështetje të shkollave të rregullta.

Nisur nga puna e këtyre mekanizmave në shkolla të rregullta, sot kemi përvoja apo praktika pozitive të cilat duhet të hulumtohen dhe dokumentohen në mënyrë që ato të shfrytëzohen nga mësuesit tjerë në Kosovë. Dokumentimi i praktikave pozitive dhe shpërndarja e tyre është një mundësi e mirë që mësimdhënësit të shkëmbejnë përvojat e tyre dhe në këtë formë krijohen mundësi për përmirësimin e cilësisë së punës së tyre me nxënësit në përgjithësi dhe ata me nevoja të veçanta në veçanti.

Cilat janë çështjet të cilat duhet t'i kemi parasysh?

Dokumentimi i praktikave të mira kërkon një qasje shumëdimensionale në mënyrë që i gjithë procesi të jetë i suksesshëm.



Paraprakisht duhet të bëhet një analizë e shkollave që ju i keni në mbështetje, në mënyrë që të identifikoni se në cilat shkolla do të fokusoheni, më pas puna vazhdon në identifikimin e mësuesve të cilët me punën e tyre me fëmijët me nevoja të veçanta kanë arritë rezultat i cili ja vlen të dokumentohet.

Paraprakisht duhet të informohet drejtori i shkollës dhe më pas edhe vet mësimmshënësi nga i cili duhet të merret një lloj miratimi nga ana e tij.

- Identifikimi i shkollave gjithëpërfshirëse;
- Identifikimi i mësimmshënësve që kane treguar "praktika pozitive" në gjithëpërfshirje
- Identifikimi i mësuesve model në fushën e gjithëpërfshirjes.

Metodat e identifikimit dhe dokumentimit të këtyre praktikave ?

Gjatë dokumentimit të praktikave të mira ju mund të përdoreni metoda të ndryshme që ju i konsideroni si relevante varësisht nga kontesti. Disa prej metodave janë:

- Vëzhgimi- në klasë ju keni mundësi të shiheni, vëzhgoni demonstrimin e metodave të caktuara që mësuesja\si mund t'i zhvillojë brenda një apo më shumë orëve varësisht sa ju keni nevojë për të arritë deri te qëllimi;
- Biseda- takimi dhe biseda me mësuesin ku ju mund të shkruani gjithë përvojën e saj\tij që ka në fushën e mësimmshënies gjithëpërfshirëse;
- Fokus grupi- organizim i fokus grupeve ku ju mund të ftoni mësimmshënës me përvojë në këtë fushë, drejtor, prind etj;
- Intervistave- me mësues, prind dhe drejtor etj;
- Anketave –me respondent të ndryshe që ju mendoni se mund t'i kontribuojnë verifikimit të këtyre praktikave.

Si dokumentohen praktikat pozitive në shkolla?

Dokumentimi i praktikave pozitive mund të bëhet në forma të ndryshme varësisht prej mundësive që keni në dispozicion. Disa prej formave janë :

- Përmes materialeve të shkruara- ku përvojat shkruhen dhe

botohen në formë libri;

- Broshurave – përmbledhin rastet e botohen në broshura;
- Video-incizimeve- dokumentimi përmes ndonjë dokumentari, spoti;
- CD-ve- materialeve të shkruara mund t’ju bashkëngjitet edhe CD-ja ku kemi mundësi të shohim si mund të demonstrohet ndonjë metodë apo orë mësimore e suksesshme;
- Fletëpalosjeve – shpërndahen informacione për shkollat model dhe mësuesit model;
- Posterëve – me fotografi dhe informacione të shkurta lidhur me këto praktika të cilat mund të shpërndahen në institucione arsimore;
- Publikimit në web-faqe të Qendrave burimore – secila qendër burimore sipas llojit të aftësisë së kufizuar që përfaqëson mund të plasojë materiale në web-faqet e tyre;
- Hapja e ndonjë portali apo vegëze- për shkëmbim të përvojave nga vetë mësime mësimdhënësit në kuadër të EMIS ose të Ueb –faqes së MASHT te pjesa që ka të bëjë me DANV mund të hapet një vegëz ku mund të vendosen këto përvoja në mënyrë që të kenë mundësi të përdorin të gjithë ata që janë të interesuar.



4. PROMOVIMI I ARSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS

Gjithëpërfshirja është çështje e të drejtave të njeriut që do të thotë çështje e arsimit për të gjithë, çështje e pranimit të diferencave, e bashkëpunimit dhe e socializimit midis të gjithë fëmijëve.

Gjithëpërfshirja ka të bëjë me sigurimin që çdo nxënës ndihet i mirëpritur dhe se nevojat e tyre unike dhe stilet e të nxënës plotësohen dhe vlerësohen.

Qendrat Burimore kanë rol të rëndësishëm në promovimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Gasja bashkëkohore në arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nënkupton bashkëpunim në mes të mësuesit të klasës dhe profesionistëve tjerë në mënyrë që të identifikojnë dhe adresojnë në mënyrë sa më profesionale nevojat e ndryshme të nxënësve. Roli i mësuesve udhëtues në këtë proces është i rëndësishëm pasi që në bashkëpunim me mësuesit e klasës pasi bëjnë identifikimin e vështirësive dhe nevojave, rekomandojnë me tej për procedurat e përfshirjes dhe dizajnojnë bashkë me faktorët tjerë si mësimdhënësin, prindin apo edhe profesionist tjerë procesin e mbështetjes së nevojshme.

Duke u nisur nga fakti që të gjithë nxënësit përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara, kanë të drejtë të barabartë për t'u arsimuar në sistemin arsimor, atëherë të gjitha institucionet arsimore kanë për obligim të krijojnë kushte dhe mundësi që t'u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të të gjithë nxënësve në mënyrë që gjithë të kenë mundësi pjesëmarrje aktive dhe përfitim maksimal nga procesi mësimor.

Shkollat gjithëpërfshirëse promovojnë dhe sigurojnë edukim dhe arsimim për të gjithë duke respektuar këto parime:

- Arsimim për të gjithë;
- Eliminim të pengesave në të nxënës;
- Rritje të pjesëmarrjes në proces arsimor;
- Përfshirje aktive në mësim;
- Bashkëpunim i ngushtë i mësimdhënësvë ("të rregullt"², mbështetës, udhëtues);

²Mësues në shkolla të rregullta.

- Partneritet mes shkollave dhe komunitetit;
- Vlerësim i njohurive në mënyrë adekuatë.

Roli i mësuesit udhëtues në këtë rrugëtim është të bashkëpunojë dhe ndihmojë shkollat në adresimin e vështirësive në të nxënë që mund të vijnë nga aftësia e kufizuar apo faktorë tjerë.

5. BASHKËPUNIMI I QENDRAVE BURIMORE ME INSTITUCIONE ARSIMORE

Qendrat Burimore në misionin e tyre kanë bashkëpunimin me institucione arsimore, mësuesi udhëtues përcjellë përvojat nga Qendra burimore tek shkollat në mënyrë që këto të fundit t'i adresojnë vështirësitë e ndryshme në të nxënë. Bashkëpunimi mes Qendrës burimore dhe shkollës fokusohet kryesisht në punët pedagogjike siç janë: qasja ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, ndihma në hartimin dhe realizimin dhe (rishikimin) e PIA-s, krijimin dhe menaxhimin e mjedisit të përshtatshëm, realizimi i të mësuarit bashkëpunues, përfshija e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në të gjitha aktivitetet brenda dhe jashtë shkollës (aty përfitojnë edhe nxënësit e tjerë të klasës), mbështetjen, krijimin dhe modifikimin e materialeve didaktike në përputhje me objektivat mësimore etj. (si të respektojnë diversitetin, të realizojnë zhvillimin e të mësuarit kooperativ, të barten konsultat e ndryshme, trajnime individuale ose grupe të mësimeve të rregullt, sipas nevojës, vlerësimi i nxënësve me PIA-a etj.). Bashkëpunimi nuk kufizohet vetëm në këtë segment por edhe në fushat tjera siç është komunikimi me prindër dhe trajnimet e stafit të shkollave në mënyrë që të ngriten kapacitetet e tyre për t'i adresuar vetë nevojat dhe vështirësitë.

Element me rëndësi në kuadër të bashkëpunimit me shkollën është edhe mënyra e komunikimit me shkollën. Mësuesit udhëtues kontaktin e parë e vënë me drejtorin e shkollës i cili në mënyrë specifike kërkon mbështetje për mësimeve, nxënës dhe prind. Me miratimin e drejtorit të shkollës, mësuesi udhëtues kontakton me mësuesit e shkollës të cilët kanë nevojë për mbështetje profesionale. Fillimisht caktohet takimi i parë pastaj ky bashkëpunim është i vazhdueshëm me mësuesin e klasës. Përpos takimeve të parapara mund të organizohen edhe takime tjera sipas nevojës, po ashtu bashkëpunimi ndodhë



edhe përmes mjeteve të komunikimit. Për çdo vështirësi specifike që mund të hasin në punën e tyre, ata mund të kontaktojnë me mësuesit udhëtues. Në shkollat ku ka mësues mbështetës bashkëpunimi mund të zgjerohet në atë mënyrë që ata të bashkëpunojnë si ekip dhe përvojnë dhe rekomandimet e mësuesit udhëtues, mësuesi mbështetës i bart dhe i fuqizon brenda shkollës.

Qendrat Burimore kanë përvojën e gjatë në proces të arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Kjo përvojë duhet të bartet me qëllim të realizimit të së drejtës për arsim cilësor në shkollën më të afërt për fëmijën.

5.1. Drejtoritë Komunale të Arsimit- DKA

Bazuar në Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës 04/L-032, arsimit parauniversitar është kompetencë e Drejtorive Komunale të Arsimit, andaj bazuar në këtë Qendrat burimore duhet të vendosin kontakte të vazhdueshme me DKA-të në mënyrë që të mbështesin promovimin e arsimit gjithëpërfshirës në institucione arsimore.

Nga viti 2014 në DKA, kemi zyrtarët e arsimit gjithëpërfshirës si urë lidhëse mes DKA-së dhe shkollave, andaj në këtë kontest bashkëpunimi i Qendrës burimore me DKA duhet të jetë i planifikuar, i rregullt dhe i koordinuar, që të përmbushen në mënyrë efektive detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe të sigurohet cilësia e punës në shkollë dhe me këtë edhe ngritja e rezultateve të nxënësve.

Për këtë Qendrat burimore për mësim dhe këshillim në Kosovë përmes shërbimeve mobile, gjegjësisht mësuesit udhëtues, e ndihmojnë DKA në promovimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Mësuesit udhëtues bashkëpunojnë ngushtë me zyrtarët për arsim gjithëpërfshirës në komuna për të:

- Identifikuar nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- Për të mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- Për trajnim të mësimdhënësve;
- Për pajisje me materiale.

Një mekanizëm tjetër brenda komunës janë edhe Ekipi Vlerësues Komunal i cili bën vlerësimin pedagogjik të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Qendrat burimore për mësim dhe këshillim përmes mësueseve udhëtues e ndihmojnë ekipin vlerësues në proces të identifikimit dhe të vlerësimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

5.2. Qendrat për punë sociale

Qendrat sociale kanë rol me rëndësi në njohjen dhe zhvillimin e mënyrës së jetesës së fëmijëve me nevoja të veçanta. Bashkëpunimi i Qendrave burimore me qendrat sociale ndihmon në identifikimin e nevojave për shkollim, rehabilitim dhe përkujdesje.

Bashkëpunimi është i ndërsjellët dhe Qendra burimore për mësim dhe këshillim dhe Qendrat për punë sociale mund të shkëmbejnë informata për personat të cilët marrim shërbime me qëllim të identifikimit dhe të intervenimit të hershëm.

5.3. Organizata joqeveritare

Mësuesi udhëtues gjatë punës së tij bashkëpunon me organizatat joqeveritare, shoqatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara si dhe organizatat tjera që merrem me personat me aftësi të kufizuara.

Bashkëpunimi me OJQ-të përmendet edhe në Udhëzimin administrativ të MASHT për Qendrat burimore 23/2013, i cili në nenin 21, pika 10 thotë:

Mësuesi udhëtues bashkëpunon me OJQ-të në:

- Identifikimin e rasteve të reja;
- Avokim për përfshirjen e fëmijëve në sistem;
- Ofrim të shërbimeve mbështetëse dhe punë ekipore;
- Zhvillimin e fushatave të përbashkëta vetëdijesuese, avokuese, etj që kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes në arsim për personat me aftësi të kufizuara;



- Punë hulumtuese dhe shkencore, publikime, konferenca, etj;
- Hartimin dhe implementimin e planeve të veprimit, strategjive dhe dokumenteve tjera të nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Përmirësim dhe plotësim të legjislacionit;
- Organizim të aktivitete të lira dhe jashtëshkollore, argëtuese, rehabilituese, kulturore dhe sportive dhe të tjera.

Bashkëpunimi me OJQ-të zhvillohet me koordinim direkt në punë dhe terren, përkatësisht me koordinim të aktiviteteve të përbashkëta rreth fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe në projekte të përbashkëta me OJQ-të.

Mësuesi udhëtues mban të informuar QB për rrjedhat e këtyre bashkëpunimeve.

6. FUNKSIONIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SHKOLLA

Sipas Deklaratës së Salamanka-s dhe Kornizës për Veprim në Arsimin për Nevoja të Veçanta (1994), përkthimi i vizionit të arsimit gjithëpërfshirës në praktikë kërkon krijimin e politikave arsimore, praktikave pedagogjike dhe mjediseve që përfshijnë të gjithë fëmijët në procesin e të mësuarit. Përfshirja shkon paralelisht me aftësinë për të siguruar shërbime mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (NVA) në shkollat e tyre të rregullta.

Gjatë 15 viteve të fundit, me mbështetjen e shumë donatorëve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka zhvilluar një sistem për të siguruar qasje dhe mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Shumë përparime pozitive janë arritur, duke filluar nga legjislacioni dhe krijimi i shërbimeve dhe mekanizmave për të siguruar mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta.

Funksionalizimi i mekanizmave kërkon koordinim dhe bashkëpunim mes këtyre mekanizmave në mënyrë që të arrijnë sa më shumë fëmijë të kenë qasje dhe të përfitojnë arsim cilësor. Në sistemin arsimor janë profesionist të ndryshëm të cilët japin kontributin e tyre në përfshirjen

e nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor, një kontribut të çmueshëm jep edhe mësuesi udhëtues pasi që vetë natyra e punës së tij është shumëdimensionale dhe varet nga institucionet dhe akterët e ndryshëm, kjo e bën punën e mësuesit udhëtues si të ndërvarur nga bashkëpunimi, sidomos me bashkëpunëtorët e ndryshëm profesional siç janë mësimitdhënësit klasor, lëndor, mësuesit mbështetës, asistentët dhe prindërit. Koordinimi dhe bashkëpunimi bëhet me qëllim të :

- Shkëmbimit të informatave;
- Shkëmbimit të përvojave;
- Shqyrtimit të progresit apo ngecjeve të nxënësve;
- Regjistrimi i rezultateve dhe të dhënave tjera.

Rrjeti i bashkëpunimit me profesionist tjerë si psikolog, pedagog special, logoped, tiflopedagog, surdopedagog, pediatër, neurolog, punëtorë social, ergopedagog dhe fusha të tjera të ngushta e bëjnë punën e tyre me kualitative por edhe shërbimet që ofrohen për nxënës të jenë më cilësore.

6.1. Bashkëpunimi me mësuesit klasor dhe lëndor

Me qëllim të krijimit të sistemit arsimor gjithëpërfshirës, fokusi kryesor është në atë se çfarë po ndodh në klasat e rregullta dhe se si të mbështeten mësimitdhënësit për t'i përfshirë dhe për t'i përmbushur nevojat e ndryshme në klasë.

Mësimitdhënësit në shkolla përballen me shumë vështirësi sa i përket:

Identifikimit dhe mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta, për të përgatitur programe dhe plane për mbështetjen individuale në shumicën e shkollave. Mungon edhe mbështetja nga mësuesit mbështetës apo asistentët, mësimitdhënësit nuk kanë njohuri, shkathtësi dhe mbështetje për të identifikuar dhe mbështetur nxënësit me nevoja të ndryshme. Qasja në kurrikulë, diferencimet e kurrikulës, nuk janë në përdorim në shkollë, të gjithë nxënësit në klasë ndjekin të njëjtën përmbajtje dhe strategji të kurrikulës. Kështu nxënësit me nevoja të veçanta nuk e kanë qasjen e duhur në kurrikulë përfshirë edhe Planet individuale arsimore (PIA) për të cilën ka shumë vështirësi të



hartohen dhe zbatohen nga ana e mësimitdhënësve. Duke parë gamën e gjerë të nevojave për mbështetje që kanë mësimitdhënësit nga shkolla, roli i mësuesit udhëtues është shumë i madh pasi që bashkëpunimi me këta mësimitdhënës ndikon në tejkalimin apo zbutjen e vështirësive që kanë për ofrimin e mësimitdhënies bazuar në nevojat individuale të nxënësve në klasë. Mbështetja nga mësuesit udhëtues duhet të ofrohet në aspektet pedagogjike që lidhet me punën në klasë si:

MËSUESI UDHËTUES NDIHMON MËSIMDHËNËSIN E KLASËS:

- Si të planifikojë mësimit dhe përgatitni materiale mësimitore për NNV
- Si të evidentohet dhe vlerësohet puna e fëmijës me NV
- Si të menaxhoj sjelljen e fëmijës në klasë dhe të klasës në përgjithësi
- Diskutoni përparimin apo ngecjen e fëmijës me prindërit dhe kujdestarët
- Si të përgatitet klasa për mësimit
- Si të ndihmoni fëmijët me nevoja të veçanta
- Ndhmoni mësimitdhënësit të planifikojnë mësimit dhe të përgatisin materiale mësimitore
- Ndhmoni mësimitdhënësit të menaxhojnë sjelljen në klasë
- Si të mbahen shënime mbi progresin e fëmijës me nevoja të veçanta.

KËSHILLAT TUAJA VAREN EDHE NGA MOSHA E FËMIJËVE DHE NEVOJAT E TYRE INDIVIDUALE, POR MUND TË PËRFSHIJNË:

- Ndhima me detyrat në klasë nën mbikëqyrjen e mësimitdhënësit
- Përgatitja e materialeve mësimitore
- Ndhima për nxënësit që të zhvillojnë vetëbesimin, pavarësinë dhe aftësitë
- Mbështetja e fëmijëve gjatë aktiviteteve sociale dhe shëtitjet jashtë
- Të vërejturit kur fëmijët janë të mërzitur dhe ngushëllimi i tyre
- Kujdesi për nevojat fizike të fëmijëve
- Dhënia e informatave dhe ndihma për mësimitdhënësit
- Ruajtja e informatave

6.2. Bashkëpunimi mes mësuesve udhëtues

Bazuar në Udhëzimin administrativ 23/2013 nëni 22 pika 2.3.4, mësuesit udhëtues takohen çdo tre muaj. Takimet e tilla kanë si qëllim shkëmbimin e përvojave, identifikimin e problemeve dhe ngritjen e kualitetit të shërbimeve.

Nën udhëheqjen e Divizionit të Arsimit me Nevoja të Veçanta Arsimore është krijuar rrjeti i mësuesve udhëtues në vend i cili ka funksionuar mirë deri në vitin 2013, por me pas rrjeti nuk ka vazhduar takimet. Takimet e tilla dhe bashkëpunimi mes mësuesve udhëtues ka bërë që shumë fëmijë të identifikohen në kohë dhe që shërbimet e mbështetjes të arrihen më shpejt.

6.3. Bashkëpunimi me mësuesit mbështetës

Mësuesit mbështetës janë profesionist, përgjegjës për koordinimin e punës edukative-arsimore dhe mbështetjen e institucionit arsimor në sigurimin e përkrahjes së nevojshme për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, këshillim dhe mbështetjen e mësimit dhe personelit të institucionit.

Në kuadër të përshkrimit të punës së tij është edhe bashkëpunimi me Qendrat burimore rreth metodave të mësimit, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore varësisht nga nevojat specifike që paraqiten në shkollë. Në këtë rast ofrimi i mbështetjes nga Qendra burimore bëhet përmes mësuesve udhëtues të cilët në koordinim me mësuesin mbështetës i ofrojnë këto shërbime në ekip në mënyrë që shkolla, mësimit dhe nxënësit të përfitojnë sa më shumë qoftë nga përvoja e tyre profesionale apo edhe ajo materiale.

Qendrat burimore me programet e tyre të trajnimit ofrojnë mbështetje në ngritjen profesionale të mësuesve mbështetës.

6.4. Bashkëpunimi me asistent për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore

Një shërbim tjetër i rëndësishëm është asistenti për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore i cili ka për detyrë që të asistojë dhe të



kujdeset për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore gjatë procesit mësimor në institucione arsimore, qoftë për nevojat fiziologjike, fizike e mjekësore apo edhe ndonjë asistencë tjetër, për të cilën fëmija ka nevojë e që nuk mund t'ia ofrojë mësimdhënësi.

Mësuesi udhëtues mund ta ndihmoj dhe udhëzoj asistentin për punën me fëmijën/nxënësin me nevoja të veçanta në çështjet që janë të nevojshme dhe duke e pavarësuar sa më shumë që është e mundur atë në punën e tij/saj. Asistentëve iu ofrohen shërbime këshilluese për obligimet e tyre, mënyrën e punës, metodat e punës, mënyrat e bashkëpunimit me mësuesin e klasës, metodat e eliminimit të sjelljeve të papërshtatshme për përdorimin e përforcuesve etj.

6.5. Bashkëpunimi me profesionist tjerë

Të punosh mësues udhëtues përveç të kesh njohuri në llojet e aftësisë së kufizuar, është me shumë interes bashkëpunimi me të gjithë personat që punojnë me fëmijën e sidomos me profesionist të fushave të ngushta.

Bashkëpunimi ndihmon në realizimin e Planit Individual të Arsimit i cili e ka edhe komponentin e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me profesionistë të fushave të ndryshme.

Mësuesit udhëtues bashkëpunojnë edhe me profesionist të fushave të ngushta të cilët në një ose formë tjetër japin shërbime rehabilituese për fëmijët si pedagog special, logoped, tiflopedagog, surdopedagog, psikolog klinik, pediatër, neurolog, punëtorë social, ergopedagog, dhe fusha të tjera të ngushta. Ky bashkëpunim përafron objektivat e punës për të zhvilluar potencialin e fëmijës.

Bashkëpunimi nevojitet edhe për planifikim të punës edukative arsimore në shkollë të rregullt, ku pjesëmarrja e ekspertit të nevojshëm është hap në avancim të rezultateve të nxënësve.

6.6. Bashkëpunimi me prindër

Prindërit/kujdestarët janë të rëndësishëm në veçantë në procesin e arsimit të fëmijëve të tyre e që kanë nevoja të veçanta. Prindi/kujdestari është vendimmarrës në këtë proces.

Me gjithë vendimmarrjen prindërit kanë nevojë të marrin mendimet nga profesionistët dhe të fund të vendosin në të mirë të arsimimit sa më adekuat, duke marrë parasysh specifikat që i ka fëmija në zhvillim. Qëllimi i bashkëpunimit është që prindërit e nxënësve të inkurajohen më shumë të bashkëpunojnë me shkollën. Përgjegjësia për komunitetin shkollor krahas shkollës do të marrin edhe prindërit si një grup, ata do të mbështesin shkollën dhe do ta bëjnë atë më të fuqishme. Ky shkëmbim i informatave dhe ideve në bashkëpunim me shkollën i forcon prindërit në suksesin me të madh të fëmijëve në shkollë dhe kontribuon në masë të madhe për të dyja palët, shkolla e fuqishme dhe prindërit të fuqishëm. Bashkëpunimi i ndërsjellë i shkollave dhe familjeve promovon edukimin dhe arsimin, andaj, ka një ndikim pozitiv në suksesin e fëmijëve në shkollë, por edhe në sjelljen e tyre të përgjithshme.

7. PËRFUNDIM

Gjithëpërfshirja është e drejtë por edhe përgjegjësi ligjore që ne kemi ndaj të gjithë fëmijëve, prandaj ekziston nevoja që shkollat të ndryshojnë në mënyrë që të plotësojnë nevojat e ndryshme të të gjithë nxënësve.

Transformimi kërkon ndryshime në përmbajtje, qasje, struktura dhe strategji që përdoren në shkollë dhe klasë. Menaxhmenti i shkollës duhet të jetë i përkushtuar ndaj transformimeve.

Mësimdhënësit e kanë një rol të rëndësishëm pasi që në shkolla gjithëpërfshirëse duhet të gjejnë mënyra për të njohur nxënësit e tyre, për të identifikuar nevojat e tyre të ndryshme, për të diferencuar në mënyrë të përshtatshme praktikën e kurrikulës dhe të vlerësimit, dhe për të siguruar mbështetjen e duhur në përputhje me nevojat e të gjithë nxënësve.

Të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të angazhohen për vizionin e përbashkët. Qendrat burimore për mësim dhe këshillim janë institucione arsimore që kanë përvojë të gjatë në arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Roli i tyre në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës është shtuar me shndërrimin e shkollave speciale në Qendra burimore të cilat përmes shërbimeve të mbështetjes kontribuojnë në rritjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor.

Udhëzuesi u punua :

Divizioni për arsimin e Nxënësve me Nevoja të Veçanta në bashkëpunim me mësuesit udhëtues në Qendra Burimore

